



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna Junik – Opstina Junik – Municipality Junik

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Kuvendi Komunal-Junik

Nr. 01-05/23

Datë: 31. 10. 2023, ora 14⁰⁰

PROCESVERBAL

Mbledhja e Pestë e Rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur më datën 31 Tetor, 2023, në orën 14⁰⁰, në lokalet e Kuvendit Komunal në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Këshilli si në vijim:

1. Besart Tofaj-nënkryetar i Komunës dhe koordinator i KKSB-së,
2. Rasim Syla- komandant i Stacionit Policor në Junik,
3. Imer Krasniqi-përfaqësues i Bashkësisë Islame,
4. Zejnepe Gaxherri-kryesuese e Komitetit për Komunitete,
5. Xhavit Velijaj-drejtor i Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
6. Xhavit Gaxherri-kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës së Junikut,
7. Xhevahire Krasniqi - zyrtare për Barazi Gjinore,
8. Arbër Gjota - përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike, dhe
9. Driton Syla-“Teqja e Madhe Amë e Tarikatit Alijjei- Haletije Xhaferi”, Junik.

Në këtë mbledhje munguan; Ruzhdi Shehu-kryetar i Komunës - kryesues i KKSB-së, Albestrim Rexhepi - përfaqësues i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Leonita Jasiqi - përfaqësuese e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Arsim Shehu - përfaqësues nga Komuniteti i Biznesit, Dukagjin Lolluni-përfaqësues nga OJQ, Afërdita Shehu - kryesuese e Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, Qamil Jasiqi-përfaqësues nga Komuniteti i Personave me Aftësi të Kufizuara, Shkëlzen Shehu-përfaqësues i Emergjencave Civile Komunale.

Mbledhjen e Pestë të Rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023 e shpalli të hapur koordinatori i KKSB-së, z. Besart Tofaj, i cili përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, dhe nga anëtarët e Këshillit kërkoj miratimin e Rendit të Ditës si më poshtë:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut,
3. Fatkeqësitë natyrore, vërshimet, erërat e forta, bllokimi i kanaleve dhe gjelbërimi,
4. Dëmtimi i shtëpive, vjedhja e gjësendeve, siguria në Komunën e Junikut dhe qetë endacakë, dhe
5. Të ndryshme.

Në mungesë të zyrtarit përkatës për raportim për pikën e tretë të Rendit të Ditës, kjo pikë u shtye për mbledhjen e radhës të KKSB-së.

Prandaj, me këtë ndryshim Rendi i Ditës me nëntë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua nga anëtarët e pranishëm në këtë mbledhje të KKSB-së.

Pika e Parë të Rendit të Ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Koordinatori i KKSB-së, z. Besart Tofaj kërkoj shqyrtimin e procesverbalit të kaluar, i cili u shqyrtua, ndërsa doli të ketë një gabim teknik, dhe dy kërkesa për riformulimin e dy fjalive brenda procesverbalit. Me këto ndryshime ky procesverbal u miratua me nëntë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Pika e Dytë e Rendit të Ditës, Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut

Komandanti i policisë në Junik, z. Rasim Sylja tha, situata e sigurisë në përgjithësi në Komunën e Junikut është e qetë që nga takimi i fundit i KKSB-së. Ne po vazhdojmë me mbulim të terrenit që është i vazhdueshëm. Po aplikojmë pika të kontrollit në hyrje dhe dalje të Junikut dhe në zonat ku kemi informata ku njerëzit po vozisin me shpejtësi pak më të madhe sa që është e lejueshme. Prioritete kemi edhe sigurinë e nxënësve në shkollë, ku çdo mëngjes kemi një pikë statike pranë shkollës dhe në bashkëpunim me të gjitha institucionet e Junikut për shërbime sa më efikase, dhe në përgjithësi angazhimet tona në bashkëpunim me institucionet komunale në Junik ka prodhuar efektin e sigurisë në përgjithësi. Nuk kemi pasë ndonjë rast që ka mundur me e prish imazhin e sigurisë ose policisë në Junik. Rregullimi i trafikut është pak defekt i yni, por janë shumë arsye që nuk është siç duhet, por ne po mundohemi vazhdimisht sa u përket numrit të parkingjeve që në ato zonë ku frekuentimi i njerëzve dhe këmbësorëve është pak më i madh, ta bëjmë më të mirën edhe për trafikun, dhe zakonisht mbajmë së paku 6 pika të kontrollit për 24 orë, ku dalim edhe për arsye të vetëdijesimit të shoferëve përmes gjobave, për shoferët që bëjnë vozitje të rrezikshme, apo ata të cilët nuk janë në rregull në trafik. Besoj që shumë shpejtë do të rregullohen edhe kamerat e sigurisë, që do të na lehtësonin mbulimin e të gjitha rrugëve, dhe do të na ndihmonte edhe në shqiptimin e gjobave, aty ku ne kemi informata dhe t'i ftojmë ata shoferë të cilët nuk i përshtaten përkufizimeve të shpejtësisë në komunikacion.

Nënkryetari, z. Besart Tofaj pyeti nëse veturat inteligjente të policisë do të qëndrojnë në Junik?

Z. Rasim Sylja tha, ato nuk kanë qenë për Junik, dhe ato janë të trafikut rajonal të Gjakovës, të cilat kanë qenë këtu në Junik. Ato aktualisht janë në numër të kufizuar, dhe zakonisht po përdoren në qendra më të mëdha, dhe pak më problematike në trafik. Por nëse është e nevojshme ne mund t'i ftojmë për disa ditë që të shërbejnë në Junik. Ato saktësojnë të gjitha kundërvajtjet që i ka një automjeti i regjistruar. Këtë vit kemi dënime rekord sa i përket shqiptimit të gjobave në trafik. Lidhur me kufizimin e shpejtësisë ne kemi bërë fushatë vetëdijesuese, por të një pjesë e njerëzve kjo nuk po merret parasysh, dhe diku rreth 95% të tiketave i kemi për tejkalim të shpejtësisë, që të jap me kuptuar se edhe përkundër gjobitjeve prapë nuk po ndalen, por megjithatë ne do të vazhdojmë t'i kryejmë punët tona.

Z. Besart Tofaj pyeti se si është ndërlidhja e aplikacionit lajmëro policine me stacionin policor në Junik.

Z. Rasim Sylja tha, qendra e kësaj është në Prishtinë, por sistemi është i lidhur në atë mënyrë që ne automatikisht njoftohemi për ankesat apo kërkesat nga qytetarët, dhe në faqen zyrtare të policisë së Kosovës postohet njoftimi sa ndaj një kundërvajtësi të caktuar janë marrë masa ligjore. Dhe, kjo ka bërë një efekt shumë pozitiv sa i përket trafikut, të shoferët e papërgjegjshëm të cilët e kuptojnë se policia nuk është e vetme, por edhe qytetari është ai që të ndëshkon.

Z. Arbër Gjota, pyeti nëse inçizimet nga vetura në veturë nga vozitësit gjatë vozitjes janë shkelje e ligjit?

Z. Rasim Sylja tha, unë besoj që këtë e ka rregulluar shteti me ligj sa u përket kundërvajtjeve në komunikacion.

Z. Driton Sylja tha, ne si shqetësim afër Teqes në Junik kemi shpejtësinë. Ajo rrugë është e ngarkuar shumë edhe nga kamionët. Për këtë ne iu kemi drejtuar Komunës, të cilët na kanë thënë se problemi është të Ministria, por prapë unë mendoj se duhet të bëhet një zgjidhje, dhe se Komuna nuk e ka marrë seriozisht këtë punë. Teqja ka shumë vizitorë dhe duhet të bëhet një zgjidhje.

Z. Besart Tofaj tha, nëse është fjala për ‘policë të shtrirë’ ajo rrugë është regjionale, dhe na pamundëson të vendosim “policë të shtrirë”, apo pengesa tjera, sikurse që nuk lejohen as në rrugët në drejtim për Botushë apo të Rastavicës.

Z. Driton Sylja tha, pavarësisht kësaj aty duhet të bëhet një zgjidhje sepse ky është një shqetësim serioz, sepse kjo rrugë ka shumë ngarkesë dhe shpejtësia e automjeteve është tepër e madhe, ku rrezikohen qytetarët dhe vizitorët.

Z. Xhavit Velijaj tha, siguria në komunikacion është shumë shqetësuese në të gjitha hapësirat urbane në Komunën e Junikut, ku infrastruktura rrugore është duke u rregulluar çdo ditë e më tepër, dhe këtu është njëfarë nxitje të shoferët për rritjen e shpejtësisë ndoshta pa vetëdije. Unë mendoj që përpos shtimit të kontrolleve të policisë duhet të punohet edhe më shumë në sinjalizim rrugor. Pra, shenjat e përkufizimit të shpejtësisë që janë në formë rrethore të vendosen edhe në mënyrën horizontale, pra në asfalt, në mënyrë që të vërehen më mirë nga vozitësit. Dhe, unë kërkoj nga Komuna përkatësisht nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, që të ndanë mjete për shenjat e komunikacionit sepse kjo do ta rrisë edhe vetëdijen e shoferëve sepse edhe shenjat vertikale janë të rralla në rrugët e Junikut.

Z. Besart Tofaj tha, ne do të bëjmë kërkesë prapë në Ministri që ta na lejohet vendosja e “policëve të shtrirë” nëpër vende të caktuara nëpër rrugët regjionale por nuk jam optimist për një përgjigje pozitive.

Z. Xhavit Gaxherri tha, unë pajtohen me shqetësimin e z. Driton Sylja dhe kërkoj që institucionet fetare dhe ato shtetërore të trajtohen me një kujdes pak më të veçantë, pra të bëhet një kërkesë e veçantë për këto kategori dhe të gjinden mënyra që ndikojnë në zvogëlimin e shpejtësisë së automjeteve, siç janë “policët e shtrirë”, sinjalizimi horizontal apo të tjera të ngjashme.

Pika e Tretë e Rendit të Ditës,
Dëmtimi i shtëpive, vjedhja e gjësendeve, siguria në Komunën e Junikut dhe qentë endacakë

Z. Besart Tofaj tha, është një shoqatë që është në bashkëpunim me Komunën dhe që i ka mbledh qentë endacakë, të cilët janë vaksinuar dhe sterilizuar, ndërsa sa i përket dëmtimeve të shtëpive dhe vjedhjeve të gjësendeve fjalën ia kaloj z. Rasim Syla.

Z. Rasim Syla tha, unë desha të pyes se pse kjo ka hyrë si pikë e rendit të ditës, sepse nuk kemi asnjë rast që dikujt i është dëmtuar shtëpia, as raste të vjedhjeve. Këto pothuajse nuk ekzistojnë fare në Junik. Pra, nuk kemi diçka që mund të evidentojmë për këtë çështje.

Ndërsa, po kthehem prapë të tema e qenve endacakë. Nuk mundet një Komunë e vetme të zgjidh këtë problem sepse ku është problem nacional, sepse p.sh. nëse eliminohen qentë e një komune, ata do të sjellën nga komunat tjera, dhe këtui është problemi. Pra, ky është problem në nivel nacional, prandaj duhet të zgjidhet në nivel nacional, përndryshe kuvendet komunale do ta kenë jashtëzakonisht të vështirë që ta zgjidhin këtë problem.

Pika e Katërt e Rendit të Ditës
Të ndryshme

Z. Imer Krasniqi tha, unë kam vërejtje për vonesën për pajisjen me lejet për dru për djegie nga Ministria e apo Parku Nacional për këtë vit, ndërsa pyeti nëse ka ndonje informacion se kur qytetarët mund të pajisen me këto leje.

Z. Besart Tofaj tha, ne kemi dërguar shkresë nga Komuna, mirëpo nuk na është kthyer ndonje përgjigje, dhe jemi në pritje të një përgjigjeje. Përndryshe, sipas planit të Bjeshkëve të Nemuna parashihet që në vitin e ardhshëm kompetencat t'i kthehen Komunës.

Z. Imer Krasniqi pyete nëse ka ndonje përgjigje nga Ministria për aplikacionet për legalizimin e staneve dhe pronave rreth tyre në bjeshkë?

Z. Besart Tofaj tha, ligji është miratuar, por rregullore dhe udhëzimi administrativ që përcakton mënyrën se si ka për tu zbatuar ai ligj nuk janë miratuar ende, kështu që kërkesat janë bërë dhe deri me datën 18 Tetor ka qenë afati i fundit. Tani Departamenti i Ministrisë do të nxjerrë rregulloren dhe udhëzimin administrativ, për taksat, çmimet dhe mënyrën e dhënies në shfrytëzim për të gjitha ato dhe nderkohë ne si Komunë duhet të hartojmë edhe planin rregullues dhe mbi të cilin do të lëshohen lejet për stanet apo për aktivitete tjera të cilat mund ti parasheh plani.

Me kaq, koordinatori, z. Besart Tofaj e shpalli të mbyllur këtë mbledhje të KKSB-së.

Procesmbajtësi,

Gëzim Geci

Kryetari i Komunës, Kryesues i KKSB-së

Ruzhdi Shehu